



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

*Kuvendi i Komunës Klinë*

01Nr. 06-9266 /2026

Datë: 01.06 /2026

*Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronjën d), nenin 17 shkronja f) dhe nenit 40. paragrafi 40.2 shkronjën l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040. Nenit 10 pikën 4) dhe Nenin 40 pikën 11 të Statutit të Komunës së Klinës i miratuar në Mars 2010, me kërkesën- propozimin e grupit kuvendar të AAK-së, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të të rregullt për vitin 2026 të mbajtur me 27.03.2026, mori këtë:*

## V E N D I M

*Për*

*Autorizimin e Kryetarit të Komunës së Klinës*

1. Miratohet propozimi i grupit kuvendar të AAK-së për autorizimin e Kryetarit të Komunës së Klinës, për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për ndërhyrje dhe rregullim të bodrumit të ndërtimit të banueshëm, i cili është ndërtuar me koncesion publik-privat mbi pronën e Komunës së Klinës, zona kadastrale Klinë, sipas certifikatës së pronësisë dhe numrit të objektit : O-71006024-00520-2-2-0.
2. Arsyeja për ndërhyrjen është gjendja e rënduar e bodrumit, i cili është prekur nga ujërat e zeza dhe paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për sigurinë dhe shëndetin e banorëve. Ndërhyrja ka për qëllim përmirësimin e gjendjes së podrumit, trajtimin e ujërave të zeza dhe sigurimin e kushteve të banimit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi i obligohet Kryetari i Komunës së Klinës dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
4. Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit, bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.



Kryesues i Kuvendit  
Enver Berisha